REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:077626
Datë: 02.09.2021
Numri i dokumentit: 02138092

C.nr.281/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Dega në Rahovec- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Dardan Hoxha në çështjen juridike kontestimore të paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. sh.a (K)- Distrikti Gjakovë, kundër të paditurit L. Th. nga fshati Xërxë, Komuna Rahovec, me objekt të padisë kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 161.68 €, me datë 02 shtator 2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

-për shkak të mosbindjes-

I. **APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. sh.a (K)-Distrikti Gjakovë.

II. **DETYROHET** i padituri L. Th. nga fshati Xërxë, Komuna Rahovec, që paditëses K. në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar, t'i paguaj shumën prej 161.68€ (njëqind e gjashtëdhjetë e një euro e gjashtëdhjetë e tetë cent), me kamat vjetore 8%, nga data 13 prill 2021(datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 20€(njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi K. K. për D. dhe F. me E. E. sh.a (K)- Distrikti Gjakovë, më datë 13.04.2021 pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurit L. Th. nga fshati Xërxë, Komuna Rahovec, me objekt te kontestit kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 161.68€.

Me aktvendimin C.nr.281/21 i datës 25.06.2021, të marr në bazë të nenit 394 dhe 395 të LPK-së, gjykata e ka obliguar të paditurin që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë me të gjitha provat materiale, të paraqes përgjigje në padi në formë të shkruar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën paditëse, nën kërcenim të pasojave ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes. Nga flet kthesa konstatohet se këtë aktvendim i padituri e ka pranuar me datë

05.07.2021, mirëpo deri në marrjen e këtij aktgjykimi i njëjti nuk i ka dorëzuar gjykatës përgjigje me shkrim në padi.

Nga shkresat e lëndës që i janë bashkangjitur padisë, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri është shpallur fajtor dhe është dënuar me aktgjykim penal P.nr.272/2019 të datës 13.11.2019, me datë të plotfuqishmërisë 06.01.2020 për veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 të KPRK-së, ne dispozitiv ceket edhe shuma e dëmit të shkaktuar nga i padituri, e njëjta shumë e dëmit (prej 161.68€) është e faktuar edhe sipas faturës DGJHP187940 datë 12.11.2018 e lëshuar nga paditësja.

Gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë nga neni 150 paragrafi 1 pika a), b) dhe c) të LPK-së, nëse të padituri i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo faktet e ditura botërisht.

Në bazë të nenit 245 par.1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) është paraparë se: "*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij".*

Meqenëse i padituri ka rënë në vonesë për kompensimin e dëmit, gjykata me kërkesë të paditësit dhe në bazë të nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e detyroi të padituri në që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën ligjore sikurse në dispozitivë të këtij aktgjykimi, duke e llogaritur nga koha e parashtrimit të padisë.

Vendimi që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjyqësore gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore, konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet taksës gjyqësore në shumë prej 20€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile
C.nr. 281/2021, datë 02 shator 2021

G j y q t a r i
Dardan Hoxha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

2021:077627